



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Të papaguar dhe të pambrojtur

Asistentët personalë bartin barrën
e kujdesit për personat me aftësi të kufizuara



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë



Hyrje

Ofrimi i asistencës personale është një shërbim thelbësor që mundëson jetesën e pavarur dhe pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara (PAK) në shoqëri, një e drejtë e njeriut e garantuar nga [Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara](#) (KDKPAK). Ky dokument i politikave shqyrton mënyrën e ofrimit të asistencës personale dhe kujdesit për PAK¹. Legjislacioni i Kosovës përdor terma të ndryshëm për personin që ndihmon një PAK, duke përfshirë "kujdestar personal", "kujdestar" dhe "shoqërues". Për të lehtësuar leximin, ky punim përdor termin "asistent personal" për t'iu referuar të gjitha këtyre roleve, si një term gjithëpërfshirës, i harmonizuar me KDKPAK. Së pari, ky dokument i politikave, analizon kornizën ligjore përkatëse për të identifikuar mangësitë kryesore ligjore, financiare dhe strukturore dhe më pas paraqet gjetjet e nxjerra nga hulumtimet ekzistuese, intervistat me 332 asistentë personalë të profileve të ndryshme, si dhe intervistat me informatorë kyç, përkatësisht dhjetë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile (OSHC) që punojnë me PAK.

Korniza ligjore

Ky seksion analizon kornizën ligjore përkatëse që rregullon ofrimin e asistencës personale.

Konventa e OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

E ratifikuar nga OKB-ja në vitin 2008, KDKPAK është një traktat ndërkombëtar për të drejtat e njeriut që garanton të drejtat themelore të personave me të gjitha llojet e aftësive të kufizuara. Qëllimi i saj është "të promovojë, mbrojë dhe sigurojë gëzimin e plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore nga të gjithë personat me aftësi të kufizuara, si dhe të promovojë respektin për dinjitetin e tyre të lindur."² Megjithatë CRPD nuk e përkufizon në mënyrë të drejtpërdrejtë aftësinë e kufizuar, ajo e njeh atë si "një koncept në zhvillim [...] që rezultojnë nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe pengesave që lidhen me qëndrimet dhe mjedisin, të cilat pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në kushte të barabarta me të tjerët."³ Kjo dispozitë thekson se aftësia e kufizuar nuk është një gjendje fikse, por një gjendje që mund të ndryshojë në varësi të mjedisit përreth, përfshirë edhe pengesat që lidhen me qëndrimet, të cilat duhet të eliminohen. Gjithashtu, ajo përcakton se PAK përfshijnë "ata që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose

¹ Ky dokument i politikave është hulumtuar dhe hartuar nga Edita Bllaca, Sanea Abboud dhe Mirjeta Ademi për Rrjetin e Grave të Kosovës (RrGK), në kuadër të projektit "Përmirësimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për të rritur qasjen në mbrojtje sociale cilësore për gra dhe burra nga grupe të ndryshme", i zbatuar nga RrGK, Organizata e Personave me Distrofi Muskulare e Kosovës (OPDMK) dhe Ruka Ruci, me mbështetjen e Bashkimit Evropian (BE). Ky projekt synon të rrisë pjesëmarrjen qytetare, të promovojë hartimin e politikave gjithëpërfshirëse dhe të mbështesë reforma që pasqyrojnë nevojat e grupeve të ndryshme, përfshirë gratë, PAK, romët, ashkalinjtë, egjiptianët, serbët dhe të tjerët. RrGK falënderon OPDMK-në, Ruka Ruci, Rrjetin e Organizatave të Grave Rome, Ashkallike dhe Egjiptiane, si dhe hulumtuesit e tyre për realizimin e intervistave në mbarë Kosovën gjatë vitit 2025. RrGK falënderon gjithashtu organizatat e shoqërisë civile (OSHC) që mbështesin PAK, asistentët personalë dhe kujdestarët për kohën dhe pjesëmarrjen e tyre në këtë hulumtim, i cili nuk do të kishte qenë i mundur pa kontributin e tyre. Falënderime të veçanta për Sanea Abboud dhe Melisë Mustafa për kontributin e tyre të madh vullnetar si hulumtuese.

² [UN Convention on the Rights of Persons with Disabilities](#) [Konventa e OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara], neni I, f. 3.

³ OKB, [Introducing the UNCRPD](#) [Hyrje në KDKPAK së OKB-së], 2022, f. 11.

shqisore”.⁴ Pra, aftësia e kufizuar nuk kufizohet vetëm në një gjendje mjekësore apo në kategori të caktuara përfituesish.⁵ Në fakt, KDPAK “vendos një ‘minimum’ dhe jo një ‘maksimum’ për përcaktimin e atyre që përfshihen” dhe “palët mund të sigurojnë mbrojtje edhe për të tjerë, për shembull për personat me aftësi të kufizuara afatshkurtra ose për ata që perceptohen si pjesë e këtyre grupeve.”⁶

E drejta për jetesë të pavarur për PAK është e garantuar në KDPAK, e cila përfshin “qasjen në një gamë shërbimesh mbështetëse në shtëpi, në ambiente rezidenciale dhe në komunitet, përfshirë asistencën personale të nevojshme për të mbështetur jetesën dhe përfshirjen në komunitet”.⁷ Ajo përcakton përgjegjësinë e institucioneve shtetërore për të ndërmarrë masa efektive dhe të përshtatshme, me qëllim lehtësimin e gëzimit të plotë të së drejtës së PAK për të jetuar, për t’u përfshirë dhe për të marrë pjesë në komunitet, me zgjedhje të barabarta me të tjerët.⁸

Komiteti i KDPAK-së për të drejtat e PAK ka theksuar, në [Komentin e Përgjithshëm nr. 5 për jetesën e pavarur dhe përfshirjen në komunitet](#), se jetesa e pavarur nënkupton lirinë për të zgjedhur dhe për të ushtruar kontroll mbi jetën e tyre me dinjitet, vetëvendosje dhe autonomi individuale. Kjo përfshin stilin personal të jetesës, aktivitetet e përditshme dhe asistencën personale. Kjo nënkupton gjithashtu zgjedhjen personale në lidhje me mënyrën e jetesës, përfshirë jetesën jashtë institucioneve rezidenciale, “pavarësisht nga niveli i kapacitetit intelektual, funksionimit të pavarur apo nevojave për mbështetje”, si dhe pavarësisht nga kostoja.⁹ Gjithashtu, Komiteti përcakton se shërbimet mbështetëse për PAK duhet të jenë të disponueshme, të qasshme, të përbalueshme dhe fleksibile për të gjithë PAK, duke marrë parasysh kushtet e ndryshme të jetesës (p.sh. të ardhurat) dhe karakteristikat personale si mosha, gjinia, përkatësia etnike, gjuha, feja, orientimi seksual apo identiteti gjinor. Sipas këtij modeli të të drejtave të njeriut, askush nuk duhet të përjashtohet në bazë të llojit apo nivelit të mbështetjes që i nevojitet.

Asistenca personale është një shërbim mbështetës për PAK, i cili është thelbësor për jetesën e tyre të pavarur.¹⁰ Sipas KDPAK-së, katër elemente e dallojnë asistencën personale: (i) financimi është i individualizuar, i bazuar në të drejta dhe i kontrolluar nga vetë PAK; (ii) PAK udhëheq dhe zgjedh mënyrën se si ofrohet asistenca dhe nga kush; (iii) asistenca është individuale (një me një) dhe asistenti nuk duhet të ofrojë shërbim për më shumë se një person pa pëlqimin e përfituesit; dhe (iv) personi mban kontrollin dhe vendimmarrjen mbi asistencën e tij/saj, në përputhje me preferencat individuale.¹¹

Sa i përket fëmijëve, KDPAK-ja i obligon shtetet të mbështesin fëmijët me aftësi të kufizuara që të jetojnë në shtëpitë dhe komunitetet e tyre, me të drejta të barabarta, duke ofruar shërbime të hershme dhe mbështetje për familjen për të parandaluar neglizhencën ose segregimin.¹² Fëmijët duhet të kenë qasje në arsim gjithëpërfshirës dhe trajnime, me mbështetje

⁴ Po aty.

⁵ Po aty, f. 12.

⁶ Po aty.

⁷ KDPAK, [neni 19](#).

⁸ Po aty.

⁹ OKB, [CRPD General Comment No.5 on living independently and being included in the community](#)[Komentin i përgjithshëm nr. 5 i KDPAK mbi jetesën e pavarur dhe përfshirjen në komunitet], 2017.

¹⁰ Po aty.

¹¹ Po aty.

¹² OKB, [Neni 23 i KDPAK](#)

të individualizuar, përshtatje të arsyeshme dhe komunikim të qasshëm, duke u mundësuar atyre të zhvillojnë aftësi jetësore, pavarësi dhe pjesëmarrje të plotë në shoqëri.¹³

Konventa e OKB-së për të drejtat e fëmijës

E miratuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 1989, [Konventa për të drejtat e fëmijës](#) (KDF) është traktat ndërkombëtar me rëndësi të madhe, i cili përcakton të drejtat themelore të të gjithë fëmijëve dhe të rinjve, si dhe detyrimet dhe përgjegjësitë e shteteve palë për të siguruar që këto të drejta të realizohen dhe mbrohen plotësisht. Sa i përket fëmijëve me aftësi të kufizuara, kjo Konventë përfshin të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara mendore ose fizike për “një jetë të plotë dhe dinjitoze, në kushte që sigurojnë dinjitetin, promovojnë vetëbesimin dhe lehtësojnë pjesëmarrjen aktive të fëmijës në komunitet.”¹⁴

Megjithëse KDF nuk i referohet në mënyrë eksplicite “asistencës personale”, ajo vendos një kornizë të rëndësishme mbështetjeje që e mbështet jetesën e pavarur të fëmijëve me aftësi të kufizuara. Neni 18 i obligon shtetet të ofrojnë ndihmë të duhur për prindërit dhe kujdestarët ligjorë në përmbushjen e përgjegjësisë të tyre prindërore dhe të sigurojnë zhvillimin e shërbimeve dhe strukturave për kujdesin e fëmijëve.¹⁵ Në vijim të kësaj, Neni 23 njeh të drejtën e fëmijës me aftësi të kufizuara për kujdes të veçantë dhe për asistencë të përshtatur sipas gjendjes së fëmijës dhe rrethanave familjare, përfshirë, kur është e mundur, ofrimin falas të shërbimeve.¹⁶ Një ndihmë e tillë duhet të lehtësojë qasjen efektive në arsim, rehabilitim, kujdes shëndetësor dhe pjesëmarrje sociale, me qëllim promovimin e integritetit sa më të plotë shoqëror dhe zhvillimit individual të fëmijës.

[Komenti i përgjithshëm nr. 9](#) i KDF-së së OKB-së thekson prioritetin e lartë të ofrimit nga shteti të kujdesit dhe mbështetjes së veçantë, përfshirë asistencën personale, për të siguruar përfshirjen e tyre, me fokus në eliminimin e pengesave sociale dhe fizike. Sipas tij, “pengesa nuk është vetë aftësia e kufizuar, por një kombinim i pengesave sociale, kulturore, të qëndrimeve dhe fizike me të cilat fëmijët me aftësi të kufizuara përballen në jetën e tyre të përditshme.”¹⁷ Standardet më të gjera dhe më të detajuara mbi asistencën personale, përfshirë për fëmijët, trajtohen më drejtpërdrejt në [Komentin e përgjithshëm nr. 5](#) të KDPAK të OKB-së për jetesën e pavarur, siç është përshkruar më sipër.

Legjislacioni i Bashkimit Evropian

Bashkimi Evropian (BE) dhe shtetet e tij anëtare janë palë në KDF dhe KDPAK. Legjislacioni (*acquis*) i BE-së për personat me aftësi të kufizuara synon të sigurojë pjesëmarrjen e tyre të plotë në shoqëri, të mbrojtë të drejtat e tyre themelore dhe të përmirësojë kushtet e tyre sociale dhe ekonomike.¹⁸ Ky legjislacion përfshin instrumente të ndryshme ligjore, strategji dhe iniciativa të mbështetura nga KDPAK-ja. [Karta e të drejtave themelore të BE-së](#) përfshin të drejtën e PAK për të përfituar nga përfshirja e tyre në shoqëri, përfshirë “përmes masave të dizajnuara për të siguruar pavarësinë e tyre, integritetin social dhe profesional dhe pjesëmarrjen në jetën e komunitetit.” [Shtylla evropiane e të drejtave sociale](#), e shpallur në vitin 2017, afirmon përmes Parimit 17 se PAK kanë të drejtën për mbështetje financiare për jetesë dinjitoze, për

¹³ OKB, [Neni 24 i KDPAK](#)

¹⁴ OKB, [Neni 23 i KDF-së](#)

¹⁵ OKB, [Neni 18 i KDF-së](#)

¹⁶ OKB, [Neni 23 i KDF-së](#)

¹⁷ OKB, [CRC General Comment No. 9 \(2006\): The rights of children with disabilities](#). [Komenti i përgjithshëm nr. 9 i KDF-së (2006): Të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara], 2007, f. 2.

¹⁸ KE, [Kosovo 2024 Report](#). [Raporti për Kosovën 2024], 2024, f. 36.

shërbime që mundësojnë pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës dhe në shoqëri, si dhe për një mjedis pune të përshtatur sipas nevojave të tyre.

[Strategjia për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara 2021-2030](#), e cila zëvendëson [Strategjinë evropiane për personat me aftësi të kufizuara 2010-2020](#), synon të përmirësojë qasjen dhe të drejtat e PAK, përfshirë eliminimin e pengesave në qasjen në shërbime shëndetësore, arsim, aktivitete rekreative dhe pjesëmarrje në politikë. Fokus kryesor është jetesa e pavarur e PAK, e cila kërkon “shërbime cilësore, të qasshme, të përqendruara te personi, si dhe të përballeshme, të bazuara në komunitet dhe familje”.¹⁹ Këto përfshijnë qasje të përballeshme në asistencë personale, kujdes mjekësor, pajisje ndihmëse, mbështetje familjare dhe ndërhyrje të punëtorëve socialë, me qëllim lehtësimin e aktiviteteve të përditshme dhe ofrimin e zgjedhjeve për PAK dhe familjet e tyre. Në vitin 2024, BE-ja ka nxjerrë një [dokument udhëzues](#) për shtetet anëtare lidhur me përmirësimet në jetesën e pavarur dhe përfshirjen në komunitet, përfshirë skemat e asistencës personale.²⁰ Ky udhëzues rekomandon që fondet të përdoren për të mbështetur punonjësit si asistentë personalë dhe programet e asistencës personale, si një shërbim thelbësor, i përqendruar te personi dhe i bazuar në komunitet për PAK, përfshirë ata me aftësi të kufizuara intelektuale dhe/ose psikosociale. Po ashtu, përshkruan asistencën personale si “një mundësues thelbësor i jetesës së pavarur dhe përfshirjes” për PAK dhe rekomandon modele financimi të përqendruara te personi, për të përshtatur fondet sipas nevojave individuale.²¹ Gjithashtu, inkurajon krijimin e një fuqie punëtore të kualifikuar, të trajnuar mirë dhe të mjaftueshme të asistentëve personalë, me kushte të drejta pune, paga më të mira dhe zhvillim të duhur profesional. Udhëzuesi sugjeron forcimin e profesionit përmes kornizave të qarta ligjore, trajnimit, mbrojtjes sociale dhe alokimit të mjaftueshëm të buxhetit publik për ofrimin e asistencës personale.

Legjislacioni kombëtar

Korniza ligjore e Kosovës, në përgjithësi, përfshin instrumentet kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, siç është KDF, por Kosova nuk është palë në KDPAK.²² Megjithëse disa parime të KDPAK-së pasqyrohen në [Kushtetutë](#), ajo nuk përmendet shprehimisht dhe nuk është e inkuorporuar plotësisht. Në vitin 2022, Qeveria nënshkroi një vendim për ndryshimin e Kushtetutës me qëllim përfshirjen e KDPAK-së.²³ Megjithatë, pavarësisht shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese, përpjekjet e mëvonshme për miratimin e saj dështuan në Kuvend për shkak të çështjeve që lidhen me votimin parlamentar.²⁴ Aktualisht, Kushtetuta garanton mbrojtje ligjore, ndalim të diskriminimit dhe barazi para ligjit për PAK, si dhe siguron të drejtën e tyre për sigurim social bazë.²⁵ Megjithatë, mund të thuhet se kjo nuk është arritur plotësisht.²⁶

¹⁹ BE, [Strategy for the Rights of Persons with Disabilities 2021-2030](#) [Strategjia për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara 2021-2030], f. 8.

²⁰ BE, [Guidance document on independent living and inclusion in the community of persons with disabilities in the context of EU funding](#) [Dokument udhëzues për jetesën e pavarur dhe përfshirjen në komunitet të personave me aftësi të kufizuara në kontekstin e financimit të BE-së], 2024.

²¹ BE, [Strategy for the Rights of Persons with Disabilities 2021-2030](#) [Strategjia për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara 2021-2030], f. 9.

²² KE, [Kosovo 2024 Report](#) [Raporti për Kosovën 2024], 2024.

²³ UN Kosovo, [Situational Analysis on the Rights of Persons with Disabilities](#) [Analiza e situatës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara], 2025, f. 17.

²⁴ Po aty, f. 64.

²⁵ [Kushtetuta e Kosovës](#), nenet 24 dhe 51.

²⁶ UN Kosovo, [Situational Analysis on the Rights of Persons with Disabilities](#) [Analiza e situatës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara], 2025, f. 17

Mbrojtja ligjore e PAK në Kosovë mbështetet aktualisht në [Ligjin nr. 05/L-021 për mbrojtjen nga diskriminimi](#), i cili ofron një kornizë të përgjithshme për ndalimin e diskriminimit, përfshirë edhe diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar. Ndërkohë, [Ligji nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës](#) përcakton një gamë të gjerë mbrojtjesh për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke afirmuar të drejtën e tyre për dinjitet, mosdiskriminim, rehabilitim, përfshirje dhe qasje në shërbime shëndetësore, sociale dhe arsimore.²⁷

Megjithatë, pavarësisht kësaj kornize, rregullimi specifik i të drejtave sociale të lidhura me aftësinë e kufizuar, përfshirë asistencën personale, trajtohet përmes një “mozaiku të fragmentuar” ligjesh të ndryshme (të përshkruara më poshtë), si dhe udhëzimeve administrative përkatëse, dhe jo përmes një kornize ligjore të unifikuar dhe gjithëpërfshirëse.²⁸

Shumica e legjislacionit në Kosovë vazhdon të mbështetet në përkufizime të ngushta ose jokonsistente të aftësisë së kufizuar, të cilat nuk janë të harmonizuara me KDPAK-në. Aktualisht përdoren²⁹ përkufizime të shumta nga institucione dhe akterë të ndryshëm”, çka bën që disa grupe të personave me aftësi të kufizuara të mos njihen ligjërisht, si për shembull personat me dëmtime mendore, intelektuale apo shqisore. Kjo situatë ka kontribuar në qasje të pabarabartë në kompensim financiar dhe në mbështetje përmes asistencës personale.³⁰

Për shembull, [Ligji nr. 08/L-255](#) i vitit 2024 [për shërbime sociale dhe familjare](#) e përkufizon PAK si “një person që ka dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose shqisore, të cilat, në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tij të plotë dhe efektive në shoqëri në kushte të barabarta me të tjerët.”³¹ Megjithëse ky përkufizim përdor gjuhë pjesërisht të harmonizuar me standardet ndërkombëtare, ai fokusohet në kategori specifike të aftësisë së kufizuar, duke e kufizuar njohjen vetëm në kategoritë e përmendura shprehimisht dhe duke përjashtuar të tjera, pasi nuk përdor formulime gjithëpërfshirëse si “përfshirë”, të cilat do të nënkuptonin ekzistencën e formave të tjera të aftësisë së kufizuar. Për rrjedhojë, ai nuk është plotësisht i harmonizuar me KDPAK-në. Si rezultat, Kosova ende nuk ka një sistem koheziv dhe të unifikuar, as kritere apo metoda të përbashkëta për identifikimin e aftësisë së kufizuar.”³²

Korniza e vlerësimit të aftësisë së kufizuar

Ofrimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse, siç janë shërbimet mbështetëse për aftësinë e kufizuar, mbështetet në procesin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, i cili menaxhohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT). Ky vlerësim shërben kryesisht për të përcaktuar të drejtën për përfitim nga skemat e pensionit për aftësi të kufizuara në rastin e të rriturve dhe nga skemat sociale për familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara.³³ Shërbimet publike sociale, siç është asistencë personale, në praktikë kufizohen kryesisht në ndihmë sociale në

²⁷ Kuvendi i Republikës së Kosovës, [Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës](#) (Neni 46), 2019.

²⁸ UN Kosovo, [Situational Analysis on the Rights of Persons with Disabilities](#) [Analiza e situatës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara], 2025, f. 18.

²⁹ Banka Botërore, [Disability Inclusion Kosovo Country Profile](#) [Profili i përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në Kosovë], 2023, f. 1.

³⁰ UN Kosovo, [Situational Analysis on the Rights of Persons with Disabilities](#) [Analiza e situatës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara], 2025.

³¹ Republika e Kosovës, [Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare](#), 2024, neni 3, f. 6.

³² Banka Botërore, [Disability Inclusion Kosovo Country Profile](#) [Profili i përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në Kosovë], 2023, f. 1.

³³ UN Kosovo, [Situational Analysis on the Rights of Persons with Disabilities](#) [Analiza e situatës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara], 2025; UNICEF, [Rishikimi i sistemeve të të dhënave administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara-Çështjet e lidhura me mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë](#), 2023.

formën e transfereve monetare, të cilat përfituesit teorikisht mund t'i përdorin për të blerë shërbime

MFPT mbështetet kryesisht në modelin mjekësor për vlerësimin e aftësisë së kufizuar të përhershme, si për të rriturit ashtu edhe për fëmijët, në vend që të zbatojë një qasje biopsikosociale të harmonizuar me standardet ndërkombëtare.³⁴ Qasja biopsikosociale bazohet në klasifikimin ndërkombëtar të funksionimit, aftësisë së kufizuar dhe shëndetit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), i cili e njeh funksionimin dhe aftësinë e kufizuar si rezultat të ndërveprimit ndërmjet gjendjes shëndetësore dhe faktorëve mjedisorë e personalë. Kjo qasje integron modelin mjekësor dhe atë social të aftësisë së kufizuar, duke ofruar një “pamje koherente të perspektivave të ndryshme të shëndetit: biologjike, individuale dhe sociale”.³⁵

Në kontrast me këtë qasje të përgjithshme, dy kategori specifike - personat e verbër dhe personat me paraplegji/tetraplegji (PPTP) - mbulohen nga legjislacioni i veçantë: [Ligji nr. 04/L-092 për personat e verbër \(2012\)](#) dhe [Ligji nr. 05/L-067 për statusin dhe të drejtat e personave me paraplegji dhe tetraplegji \(2016\)](#). Këto ligje përcaktojnë të drejtat, procedurat e vlerësimit dhe përfitimet përkatëse për këto grupe, duke i veçuar ato nga personat me aftësi të kufizuara të përhershme apo të lidhura me punën, të cilët nuk gëzojnë mbrojtje të krahasueshme ligjore. Megjithëse ligji për personat e verbër konsiderohet më gjithëpërfshirës, të dy këto ligje ofrojnë përfitime dukshëm më të fuqishme krahasuar me ato që janë në dispozicion për grupet e tjera të personave me aftësi të kufizuara, duke kontribuar kështu në mbrojtje të pabarabartë ligjore ndërmjet tyre.

[Ligji nr. 05/L-025 për shëndetin mendor](#), i miratuar në vitin 2015, ofron mbrojtje të kufizuar për personat me çrregullime të shëndetit mendor. Megjithëse ligji njeh rolin e kujdesit familjar dhe i referohet “shërbimeve të asistencës personale ose familjare”, duke obliguar institucionet shtetërore të ofrojnë mbështetje psikologjike, ndihmë familjare dhe mbështetje financiare për personat me çrregullime mendore dhe familjet e tyre, ai nuk e përkufizon dhe nuk e rregullon asistencën personale si një shërbim të veçantë, të bazuar në të drejta. Ndërkohë, grupe të tjera, si personat e shurdhër dhe personat me aftësi të kufizuara intelektuale, vazhdojnë të përballen me mungesë të njohjes dhe mbrojtjes së barabartë ligjore.³⁶

Ndihmë financiare specifike për personat me aftësi të kufizuara

Shërbimet publike sociale për personat e rritur me aftësi të kufizuara në Kosovë mbeten kryesisht të kufizuara në mbështetje financiare specifike për aftësinë e kufizuar, e cila ofrohet përmes skemave të ndryshme pensionale, me një buxhet vjetor rreth 23 milionë euro, si dhe disa programeve më të vogla, të menaxhuara nga MFPT.³⁷ Instrumenti kryesor ligjor që rregullon mbështetjen financiare për të rriturit është [Ligji nr. 04/I-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti](#), i cili përcakton ofrimin e mbështetjes financiare për PAK në formën e pensionit mujor, në kuadër të sistemit të përgjithshëm të mbrojtjes sociale në vend.

Skemat pensionale përbëjnë mekanizmin e vetëm të Qeverisë për financimin e asistencës personale, por vetëm për disa grupe të caktuara të aftësisë së kufizuar. Skemat e pensioneve për aftësi të kufizuara rregullohen në mënyrë të pabarabartë përmes akteve të ndryshme ligjore

³⁴UN Kosovo, [Situational Analysis on the Rights of Persons with Disabilities](#) [Analiza e situatës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara], 2025.

³⁵OBSH, [Towards a Common Language for Functioning, Disability and Health: ICF](#) [Drejt një gjuhe të përbashkët për funksionimin, aftësitë e kufizuara dhe shëndetin: ICF], 2002.

³⁶UN Kosovo, [Situational Analysis on the Rights of Persons with Disabilities](#) [Analiza e situatës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara], 2025.

³⁷Po aty, f. 48.

specifike për grupe të caktuara (të përshkruara më poshtë), duke rezultuar në qasje të pabarabartë në përfitime, përfshirë edhe asistencën personale. Sipas Komisionit Evropian (KE), ky sistem i fragmentuar dhe i pabarabartë pasqyron disbalanca të pushtetit, ku grupet më të organizuara ose më të dukshme të personave me aftësi të kufizuara arrijnë të sigurojnë përfitime më të favorshme, si dhe një qasje të politikave publike të udhëhequr nga synimi për uljen e kostove.³⁸

Sa i përket fëmijëve me aftësi të kufizuara, instrumenti kryesor ligjor që rregullon mbështetjen financiare për familjet është [Ligji nr. 03/I-022 për përkrahje materiale të familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme](#).³⁹ Sipas këtij ligji, “mbështetja materiale” përkufizohet si “përfitim financiar, shumë mujore ose formë tjetër pagese në para, e cila administrohet [...] për familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme”.

1) Mangësitë në skemat e pensioneve për aftësi të kufizuara të përhershme dhe të lidhura me punën

Shumica e PAK përfshihen në skemat e përgjithshme të pensionit për aftësi të kufizuara të përhershme ose për aftësi të kufizuara të lidhura me punën. Për t’u kualifikuar, aplikuesit duhet të dëshmojnë paaftësi të plotë dhe të përhershme për të punuar.⁴⁰ Vlerësimet për të rriturit kryhen nga mjekët e komisionit mjekësor pranë Departamentit të Pensioneve në kuadër të MFPT. Kriteret e përcaktuara për përfitim nga këto skema të përgjithshme përdorin gjuhë të paqartë dhe kërkesa të rrepta, duke ekspozuar shumë PAK – veçanërisht ata me çrregullime të shëndetit mendor, dëmtime të dëgjimit apo aftësi të kufizuara intelektuale – ndaj rrezikut të përjashtimit.

Institucionet vazhdojnë të zbatojnë një përkufizim të vjetëruar për aftësinë e kufizuara të përhershme nga periudha e Misionit të OKB-së në Kosovë (UNMIK), të përfshirë në [Ligjin nr. 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuara](#) (i nxjerrë si [Rregullore e UNMIK-ut nr. 2003/40](#)), i cili e përshkruan personin si “plotësisht dhe përgjithmonë të paaftë dhe të pazotë për çdo formë veprimtarie profesionale”. Ky standard i kufizuara kontribuon në përjashtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, aftësi të kufizuara intelektuale apo dëmtime të dëgjimit nga skemat pensionale dhe nga mbështetja më e gjerë sociale.⁴¹ Këto grupe, për të cilat mungon një procedurë e rregulluar vlerësimi, shpesh perceptohen si të afta për punë dhe, sipas përkufizimeve ekzistuese ligjore, zakonisht konsiderohen të papërshtatshme për të përfituar nga mbështetja financiare e institucioneve publike, përfshirë edhe qasjen në asistencë personale.⁴²

Si rezultat, shumë persona me aftësi të kufizuara nuk kualifikohen për pension për personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nevojave reale për mbështetje. Përfitimet janë fikse (120 euro në muaj) dhe të lidhura me pragun e varfërisë ekstreme, ndërsa pagesat reduktohen ose ndërpriten nëse përfituesi realizon të ardhura nga punësimi.⁴³ Këto skema **nuk** përfshijnë kompensim për asistencë personale.

³⁸ KE, [Social Protection for people with disabilities - Kosovo](#) [Mbrojtja sociale për personat me aftësi të kufizuara - Kosovë], 2022.

³⁹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, [Ligji për Përkrahje Materiale për Familjet e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme](#), 2008, f. 1.

⁴⁰ UN Kosovo, [Situational Analysis on the Rights of Persons with Disabilities](#) [Analiza e situatës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara], 2025.

⁴¹ Po aty.

⁴² Po aty.

⁴³ KE, [Social Protection for people with disabilities - Kosovo](#) [Mbrojtja sociale për personat me aftësi të kufizuara - Kosovë], 2022.

2) Programet e asistencës për personat e verbër dhe personat me paraplegji/tetraplegji

Programet e asistencës financiare specifike për personat e verbër dhe për personat me paraplegji/tetraplegji (PPTP) rregullohen me ligje të veçanta: [Ligji nr. 04/L-092 \(2012\)](#) dhe [Ligji nr. 05/L-067 \(2016\)](#). Ligji për personat e verbër konsiderohet më gjithëpërfshirës, pasi jo vetëm që garanton të drejtat në arsim dhe kujdes shëndetësor, por rregullon edhe procedurat e vlerësimit të dëmtimit të shikimit/verbërisë, financimin e rehabilitimit, përjashtimet tatimore, si dhe çështje të tjera. Asnjëri nga këto ligje nuk i adreson të drejtat dhe nevojat e PAK në përputhje me konventat ndërkombëtare. Për më tepër, duke u përpjekur të rregullojë vetëm disa grupe të aftësisë së kufizuar përmes legjislacionit specifik, legjislacioni në Kosovë ka lënë personat e tjerë me aftësi të kufizuara me skema më kufizuese dhe të fragmentuara të mbështetjes.

Të dy ligjet i ndajnë përfituesit në dy kategori bazuar në shkallën e dëmtimit. Personat e verbër përfshijnë: Kategoria I (mprehtësi vizuale nga 0 deri në 0.02, të cilët nuk mund të dallojnë dritën nga errësira) dhe Kategoria II (humbje e pjesshme e shikimit dhe mprehtësi vizuale 0.02–0.05), bazuar në raportin mjekësor.⁴⁴ Personat me PPTP përfshijnë: Kategoria I (inkontinencë e plotë dhe e përhershme dhe humbje e ndjeshmërisë në ekstremitete) dhe Kategoria II (inkontinencë e pjesshme, e përhershme dhe humbje e ndjeshmërisë në ekstremitete).

Përfituesit e Kategorisë I, që përfaqësojnë nivelin më të rëndë të aftësisë së kufizuar, kanë të drejtë për kompensim për asistencë personale, ndërsa përfituesit e Kategorisë II nuk e kanë këtë të drejtë. Në vitin 2025, niveli i përfitimit mujor ishte: personat e verbër: 300 euro për Kategorinë I (përfshirë asistencën personale) dhe 150 euro për Kategorinë II; personat me PPTP: 435 euro për Kategorinë I (përfshirë asistencën personale dhe produktet për inkontinencë) dhe 180 euro për Kategorinë II.

3) Fëmijët me aftësi të kufizuara

[Ligji nr. 03/L-022 për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme](#) zbatohet për⁴⁵ “fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme të natyrës fizike, mendore dhe shqisore” nga lindja deri në moshën 18 vjeç. Ligji e përkufizon aftësinë e kufizuar të përhershme si gjendje shëndetësore që rezulton në ⁴⁶ “pamundësi të plotë dhe të përhershme për të lëvizur ose për të kryer aktivitete të jetës së përditshme pa ndihmën e një personi tjetër”. Ai identifikon tri kategori, duke përfshirë: 1) fëmijët me kufizime në lëvizje që kërkojnë mjete ndihmëse, 2) fëmijët e verbër dhe 3) fëmijët që kanë nevojë për ndihmë në ushqyerje, veshje, përdorim të tualetit, kujdes personal dhe higjienë.⁴⁷

Duke e kushtëzuar të drejtën për përfitim me paaftësinë e plotë për të kryer aktivitetet e përditshme të jetës, ligji përjashton shumë fëmijë me aftësi të kufizuara të konsiderueshme, por të pjesshme, përfshirë fëmijët e shurdhër dhe ata me aftësi të kufizuara intelektuale, psikosociale ose funksionale të tjera, të cilët mund të kenë nevojë për mbështetje të madhe, por nuk janë plotësisht të varur.⁴⁸ Si rrjedhojë, legjislacioni krijon trajtim të pabarabartë duke përjashtuar fëmijët me aftësi të kufizuara të vlerësuara me “nivel më të ulët të ashpërsisë”, gjë

⁴⁴ Po aty, f. 7.

⁴⁵ Kuvendi i Republikës së Kosovës, [Ligji për Përkrahje Materiale për Familjet e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme](#), 2008, f. 1.

⁴⁶ Po aty.

⁴⁷ Po aty, f. 3.

⁴⁸ UNICEF, [The Legal Framework for Child Rights in Kosovo: A study of the compatibility of existing legislation with the Convention on the Rights of the Child](#) [Korniza ligjore për të drejtat e fëmijëve në Kosovë: një studim mbi përputhshmërinë e legjislacionit ekzistues me Konventën për të Drejtat e Fëmijës], 2014.

që çon në përjashtimin e fëmijëve me nevoja të rëndësishme funksionale që mund të mos e përmbushin pragun për asistencë të plotë, si dhe në mohimin e qasjes së tyre në përfitime financiare dhe shërbime përkatëse.⁴⁹

Sipas [nenit 3](#), MFPT, përmes Departamentit të Skemave Sociale, administron mbështetjen financiare për familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme përmes transfereve bankare, në përputhje me alokimet buxhetore të shtetit.⁵⁰ Ligji parashikon një përfitim mujor financiar (p.sh. 100 euro) për familjet e kualifikuara, ndërsa shuma e ndihmës përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga MFPT.⁵¹ “Kujdesi” përkufizohet në mënyrë të ngushtë si përfitim monetar që⁵² “shërben për ofrimin e mbështetjes financiare për personat që ofrojnë këtë mbështetje dhe kujdes”. Megjithatë, ligji nuk e lidh këtë mbështetje me qasje në shërbime, asistencë personale apo kujdes të bazuar në komunitet. Si i tillë, ai nuk krijon një kornizë të gjerë shërbimesh që do të mundësonte pjesëmarrjen apo jetesën e pavarur. Sipas një raporti të UNICEF-it, përfitimi prej 100 eurosh është shumë modest dhe shpesh përdoret si ndihmë kundër varfërisë, e jo për të blerë shërbime të nevojshme (të cilat shpesh as nuk ekzistojnë).⁵³

Rregullimi i asistencës personale në Kosovë

Ligjet në Kosovë përdorin terma të ndryshëm për “asistentët personalë”. [Ligji nr. 05/I-067 për statusin dhe të drejtat e personave me paraplegji dhe tetraplegji](#) përdor termin “kujdestar personal”, [ligji nr. 04/I-092 për personat e verbër](#) i referohet si “shoqërues” ose “kujdestarë”, ndërsa [ligji nr. 05/I-025 për shëndetin mendor](#) i quan “kujdestarë ligjorë”.

Aktualisht, asistencë personale është e strukturuar si një marrëveshje direkte midis PAK dhe asistentit, me përfshirje minimale të shtetit. Kompensimi për asistencën personale jepet drejtpërdrejt te PAK, jo te asistenti. PAK janë përgjegjës për zgjedhjen e asistentit të tyre, formalizimin e marrëveshjes përmes një kontrate të noterizuar dhe menaxhimit të gjithë kompensimit financiar. Asistentët mund të jenë anëtarë të familjes ose çdo individ tjetër i zgjedhur nga PAK.

Marrëdhënia ligjore midis PAK dhe asistentit personal qëndron jashtë rregullimit standard të punës, pasi zakonisht nuk ekzistojnë kontrata të qarta pune. MFPT nuk merr pjesë në përzgjedhjen, caktimin apo punësimin e asistentëve personalë. Asnjë autoritet publik nuk është drejtpërdrejt përgjegjës për mbikëqyrjen e marrëveshjeve kontraktuale, kushteve të punës apo cilësisë së shërbimeve.

Korniza ligjore nuk kërkon që asistentët personalë të posedojnë kualifikime ose trajnime të veçanta për të kryer këtë punë. [Ligji nr. 08/I-255 për shërbime sociale dhe familjare](#) e përkufizon “kujdesin social të drejtpërdrejtë” si⁵⁴ “ofrimin e ndihmës për individët në nevojë sociale, në lidhje me punët e shtëpisë, kujdesin personal, lëvizjen, komunikimin dhe mbikëqyrjen, kujdes i cili mund të ofrohet në shtëpinë e personit, në një familje tjetër, në një qendër ditore të specializuar ose në një institucion rezidencial”. Megjithatë ligji e njeh formalisht kujdesin social

⁴⁹ UNICEF, [Analiza e situatës: Fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë](#), 2017.

⁵⁰ UNICEF, [Rishikimi i sistemeve të të dhënave administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara-Çështjet e lidhura me mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë](#), 2023.

⁵¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, [Ligji për Përkrahje Materiale për Familjet e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme](#), 2008, f. 1. ; UNICEF, [Analiza e situatës: Fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë](#), 2017.

⁵² Kuvendi i Republikës së Kosovës, [Ligji për Përkrahje Materiale për Familjet e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme](#), 2008, f. 1.

⁵³ UNICEF, [Analiza e situatës: Fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë](#), 2017, f. 44.

⁵⁴ Republika e Kosovës, [Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare](#), 2024, f. 3.

të bazuar në shtëpi dhe në komunitet, duke përfshirë asistencën personale për PAK, ai nuk e rregullon asistencën personale si një shërbim të veçantë të bazuar në të drejta.⁵⁵ Si rezultat, nuk përcaktohen formalisht standarde minimale, burime të dedikuara financimi apo kualifikime për asistentët personalë. Në mungesë të standardeve minimale, financimit të dedikuar dhe zbatimit të udhëzimeve, qasja në asistencë personale në Kosovë ka mbështetur kryesisht organizata joqeveritare (OJQ) me financim jo të qëndrueshëm nga donatorët dhe në diskrecionin e komunave.⁵⁶

[Ligji nr. 03/L-212 i punës](#) garanton pagesë të drejtë, kontribute pensionale dhe kontrata pune formale. Megjithatë, korniza ligjore aktuale nuk e njeh natyrën specifike të asistencës personale dhe nuk e rregullon atë si formë pune. Nuk ekzistojnë dispozita ligjore që sigurojnë mbrojtje të punësimit për asistentët personalë, as mekanizma për garantimin e respektimit të standardeve të punës.

[Strategjia kombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar \(SKDPAK\) \(2013–2023\)](#) dhe [Plani i Veprimit Kombëtar trevjeçar përkatës \(2021–2023\)](#), i cili ka skaduar në vitin 2023, nuk trajtuan specifikisht nevojat për kujdes personal dhe nuk përmendën asistencën personale si të drejtë apo shërbim.⁵⁷ As [SKDPAK](#)-ja e re për 2025–2030 dhe plani i veprimit përkatës (2025–2027) nuk parashikojnë ndonjë dispozitë të re për asistencë financiare apo nevojë për kujdes personal.

Së bashku, këto mangësi ligjore lënë marrëdhënien e punës midis PAK dhe asistentëve personalë kryesisht të parregulluar, duke kontribuar në mbrojtje dhe standarde të paqëndrueshme, me mbikëqyrje të dobët dhe pa garanci të qarta të të drejtave të punës për asistentët personalë.

Ligji i ardhshëm për vlerësimin, njohjen e statusit, përfitimet dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuar

Në vitin 2019 u krijua një grup punues për hartimin e ligjit të ri për vlerësimin, njohjen e statusit, përfitimet dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuara. Megjithëse një draft final u përgatit në vitin 2022, ai ende nuk është miratuar. Kjo ndodh pjesërisht për shkak se grupi i punës është zëvendësuar tre herë dhe për shkak të pasigurisë mbi implikimet fiskale, të lidhura me mungesën e të dhënave të besueshme mbi numrin e PAK, gjë që ka penguar vlerësimet e sakta të kostove.⁵⁸

Ligji i ri, i njohur ndryshe si “Ligji gjithëpërfshirës”, synon të prezantojë një kornizë më gjithëpërfshirëse dhe të unifikuar për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe përfitimet përkatëse.⁵⁹ Ligji do të zbatohet për të gjitha llojet e aftësive të kufizuara, me procedura vlerësimi të kryera duke përdorur⁶⁰ “modelin biopsikosocial të vlerësimit, të bazuar në klasifikimin ndërkombëtar të funksionimit, aftësisë së kufizuar dhe shëndetit”, në vend të modelit aktual kryesisht mjekësor, për të përcaktuar statusin e aftësisë së kufizuar dhe kualifikimin për përfitime dhe shërbime

⁵⁵ Po aty, f. 7.

⁵⁶ UN Kosovo, [Situational Analysis on the Rights of Persons with Disabilities](#). [Analiza e situatës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara], 2025.

⁵⁷ KE, [Kosovo 2024 Report](#) [Raporti për Kosovën 2024], 2024; UN Kosovo, [Situational Analysis on the Rights of Persons with Disabilities](#). [Analiza e situatës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara], 2025.

⁵⁸ UN Kosovo, [Situational Analysis on the Rights of Persons with Disabilities](#). [Analiza e situatës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara], 2025.

⁵⁹ Po aty.

⁶⁰ KE, [Social Protection for people with disabilities - Kosovo](#) [Mbrojtja sociale për personat me aftësi të kufizuara - Kosovë], 2022, f.18

përkatëse. Sipas KE-së, drafti i ligjit është gjithëpërfshirës dhe synon të vendosë një qasje të unifikuar ndaj aftësisë së kufizuar, duke ndihmuar në reduktimin e fragmentimit dhe parandalimin e pabarazive midis grupeve të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara.⁶¹

Drafti parashikon krijimin e një komisioni vlerësimi multidisiplinar dhe fut kategoritë e klasifikimit të aftësisë së kufizuar, ku kompensimi lidhet me pagën minimale. Individët do të vlerësohen dhe kategorizohen në një nga katër kategori, duke filluar nga dëmtimet e lehta (Kategoria I) deri te paaftësia totale (Kategoria 4).⁶² Personat e Kategorisë 4 do të marrin pagën minimale në tërësi, ndërsa ata të Kategorisë I do të marrin 50% të saj. Përfituesit e kualifikuar do të marrin gjithashtu një shtesë për produktet për inkontinencë dhe për plagët nga qëndrimi në shtrat (dekubitus), që shkon deri në 50% të kompensimit të tyre. PAK që kanë nevojë për asistencë 24-orëshe do të kenë të drejtë të kenë më shumë se një asistent personal. Asistenti, i zgjedhur ose nga vetë përfituesit ose nga Qendra për Punë Sociale (QPS), do të jetë i detyruar të përfundojë një trajnim të akredituar para nënshkrimit të kontratës.⁶³ KE ka rekomanduar miratimin e këtij ligji si pjesë e obligimeve të Kosovës në Kapitullin 23 të procesit të anëtarësimit në BE.⁶⁴

Gjetjet kryesore

Sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë për vitin 2024, rreth 8% deri në 10% e popullsisë së Kosovës (337,859 qytetarë) jeton me kufizime funksionale të lidhura me shikimin, dëgjimin, lëvizshmërinë ose komunikimin.⁶⁵ Sipas MFPT, ekzistojnë 4,759 PAK të regjistruar⁶⁶ që përfitojnë mbështetje nga shteti. Sipas të dhënave të marra nga MFPT, ka 1,520 persona të verbër që kanë një asistent personal. Ndër përfituesit PPTP, 2,413 kanë një asistent personal dhe të gjithë i përkasin Kategorisë I. Në Kategorinë 2, ka 102 përfitues PPTP që kanë një asistent personal të përhershëm dhe 361 që kanë një asistent personal të përkohshëm. Mungesa e një regjistri publik të PAK dhe asistentëve e ka bërë të pamundur përzgjedhjen e rastësishme të pjesëmarrësve. Për këtë arsye, pjesëmarrësit e anketës u përzgjedhën duke përdorur metodën e *snowball sampling*, të kombinuar me përzgjedhje të qëllimshme të mostrës me variacion sipas gjinisë së asistentit personal, llojit dhe shkallës së aftësisë së kufizuar, vendndodhjes gjeografike, etnisë dhe marrëdhënies me asistentin personal (p.sh. anëtar familjeje kundrejt kujdestarit të jashtëm).

Në këtë seksion janë të paraqitura gjetjet nga anketa me asistentët personalë, intervistat me informatorë kyç dhe literatura mbi kushtet e punës dhe jetesës së asistentëve personalë. U mblodhën gjithashtu vëzhgime nga terreni dhe të gjitha të dhënat iu nënshtruan triangulimit për të rritur vlefshmërinë e tyre. Analiza fillon me identifikimin e profilit demografik të asistentëve personalë dhe kushteve socio-ekonomike të punës së tyre, me fokus të veçantë në mënyrën se si normat gjinore dhe nivelet aktuale të kompensimit krahasohen me standardet kombëtare të pagave dhe kostot e jetesës. Për të formësuar politikat e ardhshme, ky seksion përfshin edhe vlerësime buxhetore për rregullimin e mbështetjes financiare qeveritare në përputhje me pagat

⁶¹ KE, [Social Protection for people with disabilities - Kosovo](#) [Mbrojtja sociale për personat me aftësi të kufizuara - Kosovë], 2022

⁶² Po aty.

⁶³ Po aty.

⁶⁴ KE, [Kosovo 2024 Report](#) [Raporti për Kosovën 2024], 2024.

⁶⁵ ASK, [Regjistrimi i popullsisë](#), 2024

⁶⁶ Nga 332 pjesëmarrës në anketë, 42% ishin shqiptarë (n=138), 39% serbë (n=130), 9% romë (n=31), 6% ashkali (n=19), 2% egjiptianë (n=7), 2% boshnjakë (n=6) dhe 0.3% turq (n=1). Llojet e aftësive të kufizuara që kishin PAK të asistentëve të anketuar përfshinin paraplegji (49%), tetraplegji (25%), çrregullime të shëndetit mendor (13%), aftësi të kufizuara intelektuale ose zhvillimore (11%), sëmundje kronike fizike (9%), verbëri (9%) dhe shurdhësi (4%).

minimale dhe mesatare kombëtare për periudhën 2025–2027. Më tej, shqyrtohen pasojat shëndetësore dhe sociale të kësaj pune, duke trajtuar mungesën e trajnimeve formale, ndikimin fizik të kujdesit dhe mungesën e mbrojtjes sociale. Së fundi, raporti identifikon prioritetet dhe sfidat e raportuara nga asistentët personalë, duke përfshirë nevojën për njohje profesionale dhe mbështetje institucionale në arsim, si dhe domosdoshmërinë për adresimin e barrierave mjedisore në infrastrukturën publike.

Kush ofron kujdes dhe në çfarë kushtesh?

Gratë janë dukshëm më të prirura se burrat të punojnë si asistente personale. Nga 332 asistentë personalë të identifikuar dhe intervistuar nga RrGK, 72% ishin gra, dhe moshë mesatare e tyre ishte 50 vjeç. Kjo pasqyron norma të thella gjinore, sipas të cilave gratë shpesh caktohen në mënyrë sociale për role të papaguara të kujdesit. Në shumicën e rasteve, asistentët personalë ishin anëtarë të familjes së personave me aftësi të kufizuara (83%); të tjerët ishin të rekomanduar nga dikush që ata njihnin (8%), miq ose fqinjë (4%), ose të punësuar nga familja (3%).

“Nënat nuk mund të punësohen, sepse fëmijët nuk i lënë të flenë gjithë natën dhe kanë nevojë për mbikëqyrje të vazhdueshme.”

- Asistente personale

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), të dhënat më të fundit tregojnë se paga mesatare bruto në Kosovë ishte 639 euro në vitin 2024 dhe paga neto 552 euro.⁶⁷ Punëtorët socialë që kryejnë punë të ngjashme, megjithëse me kërkesa më të larta arsimore dhe përgjegjësi menaxhimi rasti, duket se fitojnë mesatarisht 750 euro bruto në muaj.⁶⁸ Kompensimi i asistentëve personalë është dukshëm më i ulët se këto nivele. Gjysma e asistentëve të intervistuar raportuan se nuk merrnin asnjë kompensim, ndërsa ata që paguheshin deklaruan se merrnin 120, 150 ose 180 euro në muaj, varësisht nga kategoria e aftësisë së kufizuar të personit për të cilin kujdeseshin, e përcaktuar me ligj. Pra, kompensimi i financuar nga shteti për asistentët personalë mbetet dukshëm nën pagën minimale prej 425 euro dhe nuk mbulon shpenzimet bazë të jetesës, e lëre më ngarkesën e punës, njohuritë, përvojën apo kohën e nevojshme. Të gjithë pjesëmarrësit në hulumtim theksuan se kjo shumë nuk është e mjaftueshme për të përmbushur nevojat bazë. Do të ishte e vështirë të gjendej dikush i gatshëm të punonte me një pagë kaq të ulët, prandaj mbështetja jepet kryesisht nga anëtarë të familjes, shpesh nga nënat. Për të siguruar kujdes dinjitoz dhe të qëndrueshëm, pjesëmarrësit rekomanduan rritjen e mbështetjes financiare në të paktën 600 euro në muaj, duke e konsideruar këtë nivel si kompensim të drejtë. Kjo do të ishte në përputhje me pagën mesatare bruto.

Ndërkohë, 80% e asistentëve personalë të anketuar punojnë pa kontrata formale që përcaktojnë qartë të drejtat e tyre, duke i ekspozuar ndaj rreziqeve si puna jashtë orarit pa pagesë dhe shkelje të tjera të të drejtave të punës. Dy të tretat e këtyre asistentëve ofronin kujdes për 13 deri në 24 orë në ditë, dhe më shumë se 80% punonin shtatë ditë në javë. Ky kujdes i vazhdueshëm, pa pushim ose zëvendësim, përbën punë të jashtëzakonshme në shkelje të të drejtave të tyre të punës, të cilat parashohin pagesë për punën jashtë orarit. Megjithatë, nivelet e kompensimit nuk përputhen me intensitetin e kujdesit të kërkuar. Mungesa e dispozitave ligjore që trajtojnë marrëdhënien specifike të punës midis asistentëve personalë dhe

⁶⁷ ASK, [Niveli i pagave në Kosovë](#), 2024.

⁶⁸ Përlllogaritja e RrGK-së: bazuar në buxhetin e vitit 2026, Departamenti i Shërbimeve Sociale në të gjitha komunat (460 punonjës) ka një alokim total vjetor prej 4,140,819 €, që barazohet me afërsisht 9,002 € për punonjës në vit dhe 750 € në muaj.

PAK që i punësojnë ata krijon sfida të mëdha për sigurimin e mbrojtjes së duhur të punës dhe sociale, veçanërisht kur PAK kanë nevojë për kujdes 24-orësh.

Në përgjithësi, gratë në Kosovë shpenzojnë mesatarisht 7.1 orë në ditë për kujdes të papaguar dhe punë shtëpiake, më shumë se trefishi i kohës së burrave, gjë që konsiderohet si një nga arsyet kryesore për mosaktivitetin e tyre në tregun formal të punës.⁶⁹ Mungesa e njohjes së punës së asistentëve personalë si punë formale kontribuon ndoshta në shkallën alarmante të ulët të punësimit të grave në Kosovë (shkalla e punësimit është 39%, ndërsa vetëm 21% e grave janë të punësuar).⁷⁰ Kjo forcon pabarazitë gjinore, duke i lënë gratë në pozitë ekonomike më të dobët,

Kosto të vlerësuara për kompensimin e duhur të asistentëve personalë

Ky seksion vlerëson alokimet buxhetore qeveritare të nevojshme për të paguar asistentët personalë të personave të verbër dhe individëve PPTP në mënyrë më të drejtë, duke respektuar të drejtat themelore të punës. Tabela 1 krahason pagesat aktuale mujore për asistentët personalë në Kosovë me pagat e propozuara, bazuar në pagën minimale mujore bruto për vitin 2026 prej 425 euro dhe pagën mesatare bruto prej 639 euro. Aktualisht, asistentët për individët me PPTP marrin vetëm 180 euro në muaj, që arrin në 21,600 euro në vit. Asistentët për personat e verbër marrin 150 euro në muaj, gjithsej 1,800 euro në vit.⁷¹ Nëse asistentët personalë do të paguheshin me pagën minimale prej 425 euro në muaj, shpenzimi total për kategorinë PPTP do të ishte 17,416,500 euro në vit. Për personat e verbër, kjo do të kushtonte 9,343,200 euro në vit. Ky model do të reduktonte ndjeshëm diferencën midis niveleve aktuale të mbështetjes dhe kostos reale të jetesës. Duke i përshtatur këto pagesa të paktën me pagën minimale kombëtare, shteti do të siguronte stabilitetin financiar të nevojshëm dhe njohje formale për të gjithë asistentët personalë.

Bazuar në propozimin e pjesëmarrësve të hulumtimit për rritjen e kompensimit në 600 euro si shumë të drejtë për një jetë dinjitoze, paga mund të lidhej me pagën mesatare bruto në Kosovë, duke e rritur kompensimin në 639 euro në vitin 2025. Kjo do të njihje kushtet e tyre të punës që shkojnë përtej pagës minimale; gjithashtu do të mundësonte që familjet të punësonin persona të tjerë për të ofruar asistencë personale sipas nevojës. Shpenzimi total për kategorinë PPTP, nëse zbatohet paga minimale bruto, do të rritej me 6 milionë euro në vit krahasuar me shpenzimet aktuale. Nëse, në vend të saj, zbatohet paga mesatare bruto, kjo diferencë vjetore rritet në 22 milionë euro. Për kategorinë e personave të verbër, diferenca e buxhetit shtetëror krahasuar me shpenzimet aktuale do të ishte 6 milionë euro në vit për pagën minimale dhe 9 milionë euro për pagën mesatare bruto.

Tabela 1. Kostot e vlerësuara për financimin nga qeveria të asistentëve personalë								
	Gjithsej kostoja aktuale		Gjithsej kostoja e vlerësuar		Gjithsej për një vit	Parashikimi i buxhetit për KASh 2025–2027 për PPTP dhe personat e verbër		
	PPTP	Personat e verbër	PPTP	Personat e verbër	Personat me PPTP dhe personat e verbër	2025	2026	2027
	Në vit	Në vit	Në vit	Në vit	Në vit	3 vite	3 vite	3 vite

⁶⁹ RrGK, [Nën hije: Analizë gjinore e punës joformale në Kosovë](#), 2024.

⁷⁰ ASK, [Anketa e fuqisë punëtore](#), 2024.

⁷¹ ZKM, [Vendimet nga mbledhja e 273-të e Qeverisë](#), 2025.

Pagesa aktuale	2,160 €	1,800 €	6,267,600 €	2,815,500 €	10,899,720 €	18,802,800 €	8,446,500 €	27,249,300 €
Paga minimale (bruto)	5,100 €	4,200 €	17,758,200 €	7,883,400 €	25,641,600 €	53,274,600 €	23,650,200 €	76,924,800 €
Paga mesatare (bruto)	7,668 €	6,252 €	26,699,976 €	11,735,004 €	38,434,980 €	80,099,928 €	35,205,012 €	115,304,940 €

Tabela 1 vlerëson buxhetin për vitet 2026 dhe 2027 për të mbështetur kornizën afatmesme të shpenzimeve për financimin e asistentëve personalë të personave të verbër dhe individëve me PPTP. Në baza vjetore, kompensimi për të dy kategoritë, i llogaritur bazuar në pagën minimale bruto, do t'i kushtonte shtetit rreth 53 milionë euro, ose 80 milionë euro nëse llogaritet sipas pagës mesatare bruto. Për vitin 2027, mbulimi i të dy kategorive sipas pagës minimale bruto do të kushtonte 77 milionë euro dhe 115 milionë euro sipas pagës mesatare bruto.

Vlen të përmendet se, pas reformave të planifikuara ligjore, kategori shtesë të personave me aftësi të kufizuara mund të kenë së shpejti të drejtë për asistencë personale,⁷² gjë që do të kërkonte vlerësime të reja buxhetore bazuar në numrin e pritshëm të përfituesve. Numri i përfituesve sipas ligjit të ri mund të rritet në varësi të nivelit të ashpërsisë së aftësisë së kufizuar. Kjo mund të shkaktojë një kosto shtesë për buxhetin shtetëror prej 35 milionë eurosh, bazuar në pagën minimale bruto, dhe 52 milionë eurosh, bazuar në pagën mesatare bruto, duke marrë parasysh inflacionin e parashikuar prej 3%.⁷³

	2026	2027	2028
	Kompensimi aktual për personat e verbër dhe PPTP	Kompensimi i vlerësuar pas ligjit të ri bazuar në nivelin e vështirësisë	Kompensimi i vlerësuar pas ligjit të ri bazuar në nivelin e vështirësisë
Paga aktual	9,083,100 €	/	/
Paga minimale (bruto)	25,641,600 €	34,945,698 €	34,945,698 €
Paga mesatare (bruto)	38,434,980 €	52,539,606 €	52,539,606 €

Pasojat shëndetësore dhe sociale

Korniza ligjore aktuale nuk kërkon që asistentët personalë të kenë ndonjë kualifikim specifik. Rreth 70% e asistentëve personalë nuk kanë pasur kurrë trajnime formale dhe mbështeten vetëm në përvojën personale. Edhe pse pjesa tjetër ka pasur disa trajnime nga organizata si Hendifer, u vu re se asistentët personalë nga komuniteti serb rrallë kanë pasur mundësi të tilla. Ata theksuan se nevojat e tyre për të

“Nuk jemi të trajnuar profesionalisht për të qenë asistentë personalë për PAK, gjë që na shkakton ngarkesë të madhe emocionale dhe fizike.”

- Asistent personal

⁷² Drafti i ri i ligjit ishte paraparë të hynte në fuqi në vitin 2025.

⁷³ Banka Botërore, [Kosovo MPO, 2025](#)

mbështetur personat me aftësi të kufizuara janë shumë specifike dhe se duhet të fillohet nga bazat, si ofrimi i ndihmës së parë. Kjo mungesë përgatitjeje profesionale kufizon cilësinë e kujdesit, pasi asistentët shpesh nuk janë të pajisur për të menaxhuar nevoja komplekse si sfidat të lidhur me sjelljen, barrierat në komunikim ose emergjencat mjekësore. Gjithashtu, kjo i ekspozon të dy palët, si asistentët ashtu edhe PAK, ndaj rrezikut nga lëndimet. Kur u pyetën për nevojat e tyre, të anketuarit përmendën trajnime të specializuara mbi autizmin, menaxhimin e stresit, aftësitë e komunikimit (përfshirë gjuhën e shenjave) dhe mbështetjen psikologjike.

Në disa raste, kualifikimet e pamjaftueshme të asistentëve personalë kanë çuar në lëndime fizike për ta ose për PAK, në djegie profesionale (burnout) dhe në sfida të tjera.⁷⁴ Nuk ekziston mbikëqyrje e kushteve të tyre të punës, duke lënë si cilësinë e kujdesit për PAK, ashtu edhe mirëqenien e asistentëve personalë të pamonitoruar dhe të pambështetur.

Ndikimi mbi shëndetin e asistentëve personalë është i konsiderueshëm. Afërsisht gjysma e asistentëve të anketuar treguan se kanë dhimbje shpine, kryesisht për shkak të ngritjes dhe lëvizjes së PAK pa mbështetje teknike ose ndihmë shtesë. Siç shprehet një prej tyre: “E kam të vështirë ta kthej personin në shtrat vetë. Jam pa gjumë.” Të tjerë përmendën dhimbje koke, lodhje dhe shqetësime emocionale. Një pjesëmarrës shpjegoi: “Gjithmonë duhet të jem pranë personit, nuk kam kohë për veten.” Kjo dëmton jetën private të asistentëve personalë dhe mundësinë e tyre për punësim. Informatorët kyç vunë re se nënat që shërbejnë si asistente personale shpesh janë të izoluar shoqërisht, të lodhura në mënyrë kronike dhe në rrezik të zhvillimit të depresionit. Tabela 3 përmbledh kushtet e punës të raportuara nga asistentët personalë.

Tabela 3. Kushtet e punës së asistentëve personalë sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë												
Gjetjet kryesore	Shqiptar/e		Serb/e		Rom/e		Ashkali/ke		Egjiptian/e		Gjithsej (Kosovë)	
	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra
Nuk kanë kontratë formale	83%	17%	65%	35%	38%	62%	76%	24%	67%	33%	66%	34%
Ofrojnë kujdes 13-24 orë çdo ditë	92%	8%	66%	34%	73%	27%	86%	14%	100%	/	83%	21%
Punojnë 7 ditë në javë	91%	9%	64%	36%	35%	65%	83%	17%	83%	17%	71%	29%
Nuk marrin pagë	84%	16%	65%	36%	50%	50%	60%	40%	67%	33%	65%	35%
Kanë dhimbje shpine	87%	13%	63%	37%	22%	78%	100%	/	67%	33%	68%	40%
Nuk kanë trajnime	83%	17%	66%	34%	63%	37%	79%	21%	71%	29%	72%	28%
Gjithsej sipas	87%	14%	65%	35%	47%	53%	81%	23%	76%	29%		

⁷⁴ Grupi i fokusit i RrGK-së me OShC-të që punojnë me personat me aftësi të kufizuara, prill 2022.

përkatësisë etnike											
--------------------	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Prioritetet dhe sfida të identifikuar nga asistentët personalë

Kur u pyetën se çfarë do të përmirësonte situatën e tyre, pjesëmarrësit në hulumtim e vendosën në rend të parë kompensimin më të lartë dhe të qëndrueshëm, njohjen e të drejtave të punës dhe mbështetje më të madhe institucionale. Asistentët personalë

“Të ardhurat janë të pamjaftueshme; na nevojitet një pagesë më e mirë, përfitime, sigurim shëndetësor dhe më shumë trajnime për asistentët personalë dhe prindërit.”

- Asistent personal

theksuan rëndësinë e shërbimeve të kujdesit ditor dhe pushimit të mbështetura nga shteti për të ulur barrën e punës së tyre. Një nga shqetësimet që ata përmendën është numri i kufizuar i qendrave ditore ose, në disa zona, mungesa e tyre e plotë. Për më tepër, nuk ekziston një listë zyrtare e publikuar me numrin total të qendrave ditore në nivel vendi. Edhe pse raportohet se disa ekzistojnë qendra ditore, mungesa e informacionit të qasshëm dhe të përditësuar e vështirëson përcaktimin e numrit aktual të tyre. Referencat e disponueshme tregojnë praninë e qendrave ditore në komunat e Prizrenit, Pejës, Ferizajt, Gjilanit, Mitrovicës, Gjakovës dhe Prishtinës.

Asistentët personalë kërkuan gjithashtu trajnime profesionale për të reduktuar barrën fizike dhe emocionale të kujdesit. Ata kërkuan qasje më të mirë në shërbime thelbësore si asistentë në shkolla, psikologë klinikë, logopedë dhe qendra të kujdesit rezidencial. Edhe pse Kushtetuta dhe korniza ligjore garantojnë të drejtën për arsim parashkollor, duket se nuk ekziston financim shtetëror për pagesën e asistentëve personalë në institucionet parashkollore. Pjesëmarrësit në hulumtim raportuan se familjet duhet t’i paguajnë vetë asistentët personalë në çerdhe dhe, në disa raste, edhe në shkolla. Familjet përballen me shpenzime të larta dhe shpesh të papërbalueshme, duke marrë parasysh se asistencë personale është vetëm një nga disa shpenzimet për mbështetjen e fëmijëve të tyre me aftësi të kufizuara.⁷⁵ Kjo mund të rrezikojë qasjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim, rezultatet e tyre arsimore dhe autonominë e tyre në të ardhmen, duke cenuar KDPAK-në dhe të drejtën e tyre themelore për arsim. Duke qenë se vlerësimi i kostove të asistentëve personalë në të gjitha nivelet e arsimit ishte jashtë fushës së këtij hulumtimi, qeveria duhet të bëjë një vlerësim më të saktë të këtyre shpenzimeve për të mbrojtur të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara për arsim.

Barrierat mjedisore, si trotuaret e dizajnuara keq dhe të papërshtatshme për qasje, hapësirat publike dhe transporti, e vështirësojnë më tej rolin e asistentëve personalë.⁷⁶ Përdoruesit e karrocave dhe personat me dëmtime të shikimit shpesh nuk kanë opsione të sigurta për lëvizje. Një pjesëmarrës tha: “Me 150 €, nuk mund të gesh askënd për ta shoqëruar

⁷⁵ E drejta për arsim për fëmijët me nevoja të veçanta garantohej nga neni 47 i Kushtetutës, i cili siguron arsim falas dhe parashikon rregullim të veçantë për personat me nevoja specifike. Kjo është zbatuar më tej përmes [Udhëzimit Administrativ \(MASHTI\) Nr. 03/2022](#), neni 4, i cili përjashton shprehimisht fëmijët nga grupet e cënueshme nga pagesat për regjistrim në arsimin parashkollor. Po ashtu, [Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar](#) e përcakton arsimin gjithëpërfshirës si prioritet. Megjithatë këto korniza ligjore e garantojnë të drejtën e qasjes në arsim, Programi i ardhshëm i kuponëve (2028) përfaqëson një mekanizëm të planifikuar fiskal që synon të mbushë hendekun midis të drejtave të përcaktuara me ligj dhe përfshirjes praktike të fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet parashkollore.

⁷⁶ RrGK, [Analiza gjinore e transportit tokësor në Kosovë](#), 2025.

një person të verbër gjithë ditën... ndonjëherë mund t'ia lejojnë vetes të dalin vetëm një herë në muaj me taksi." Përmirësimi i qasjes në infrastrukturë dhe transport do të përmirësonte ndjeshëm jetën e tyre. PAK në zonat rurale Personat me aftësi të kufizuara në zonat rurale përballen me më shumë marginalizim, pasi shërbimet thelbësore zakonisht janë të përqendruara në qendrat urbane dhe opsionet e transportit të qasshëm shpesh janë të kufizuara ose mungojnë.⁷⁷ Mungesa e transportit përbën gjithashtu një pengesë të madhe për fëmijët me aftësi të kufizuara për të ndjekur shkollimin.⁷⁸

Përfundim

Në Kosovë, korniza ligjore dhe financiare që mbron të drejtat e PAK dhe rregullon asistencën personale mbetet e fragmentuar, e pamjaftueshme dhe me zbatim jo të njëtrajtshëm. Legjislacioni dhe politikat kombëtare nuk janë harmonizuar me kornizën ndërkombëtare, si KDPAK dhe acquis-i i BE-së në fushën e të drejtave të PAK.⁷⁹ Ligjet dhe strategjitë shpesh e kanë anashkaluar asistencën personale, duke i lënë PAK dhe kujdestarët e tyre të mbështeten në përfitime të pamjaftueshme, fonde të paqëndrueshme nga donatorët dhe mbështetjen familjare. Mbështetja financiare shtetërore ndryshon sipas grupeve të aftësisë së kufizuar, dhe vetëm disa grupe përfitojnë mbështetje financiare të dedikuar për asistencën personale. Pagesa është dukshëm nën pagën minimale. Paga e ulët, puna pa kontrata dhe mungesa e kontributeve pensionale përbëjnë shkelje të të drejtave të punës. Pak individë janë të gatshëm të sakrifikojnë kohën, mirëqenien fizike dhe sigurinë financiare për këtë punë, duke bërë që anëtarët e familjes, kryesisht gratë, të kryejnë këtë punë të papaguar ose të nënpaguar. Shumica e asistentëve personalë punojnë në kushte të pasigurta, me pasoja negative për shëndetin e tyre dhe të personave me aftësi të kufizuara. Fakti që këtë punë zakonisht e kryejnë gratë përforcon pabarazitë gjinore dhe kontribuon në feminizimin e varfërisë, veçanërisht në fazat e mëvonshme të jetës.

Rekomandimet

Për Ministrinë e Financave⁸⁰

- Të rritet mbështetja financiare për asistencën personale në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, duke e përafëruar pagën të paktën me nivelin e pagës minimale prej 425 euro në muaj, me një kosto totale prej 53 milionë euro në vitin 2026, 23 milionë euro në 2027 dhe 77 milionë euro në 2028.
- Të përfshihen këto shpenzime në ciklet vjetore buxhetore, duke përdorur buxhetimin e përgjegjshëm gjinor çdo vit për të llogaritur saktë kostot, duke marrë parasysh rritjen e popullsisë dhe numrin shtesë të PAK që kualifikohen për shërbime sipas çdo reforme ligjore. Të merren parasysh dhe të vlerësohen kostot për orët e nevojshme të kujdesit, nivelin e varësisë dhe nevojën për mbështetje 24-orëshe, duke rritur buxhetin në varësi të faktit nëse PAK kanë nevojë për më shumë se një asistent personal, në përputhje me ligjin e ri të propozuar.
- Të sigurohet indeksimi vjetor i kompensimit për aftësi të kufizuara, bazuar në koston e jetesës dhe inflacionin.

⁷⁷ UN Kosovo, [Situational Analysis on the Rights of Persons with Disabilities](#) [Analiza e situatës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara], 2025.

⁷⁸ Po aty.

⁷⁹ KE, [Kosovo 2024 Report](#) [Raporti për Kosovën 2024], 2024, f.34

⁸⁰ E njohur më parë si Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

- Të ndahet një linjë buxhetore e dedikuar dhe e qëndrueshme për asistencën personale, e pavarur nga skemat e përgjithshme të pensioneve, për të mundësuar buxhetim më të saktë dhe transparent.
- Të krijohet një program nacional i akredituar për trajnimin dhe certifikimin e të gjithë asistentëve personalë, duke ofruar trajnime falas mbi kujdesin specifik për aftësitë e kufizuara, mbështetjen për lëvizshmëri, teknikat e sigurta të bartjes për të reduktuar ngarkesën fizike, si dhe mbështetje psikologjike për stresin dhe djegien profesionale. Kjo do të rezultonte në kualifikime të certifikuara. Të përfshihen alokime buxhetore vjetore. për ofrimin e trajnimeve, certifikimin dhe kostot e instruktorëve
- Të kërkohet përfundimi i trajnimeve të akredituara para nënshkrimit të kontratave të asistentëve personalë, me një periudhë tranzitore për të mundësuar marrjen e kualifikimeve.
- Të krijohet një regjistër nacional i PAK dhe asistentëve personalë për të përcjellë ofrimin e shërbimeve, boshllëqet në mbulim dhe nevojat e fuqisë punëtore, me kostot e përfshira në buxhetin për TI dhe atë administrativ të ministrisë.
- Të vendoset një mekanizëm monitorimi dhe sigurimi të cilësisë nga Inspektorati i Punës për të mbikëqyrur marrëveshjet kontraktuale, respektimin e standardeve të punës dhe cilësinë e shërbimeve të asistentëve personalë, me buxhet të mjaftueshëm për inspektim, mbledhje të dhënash dhe raportim, duke përdorur buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe analizën e nevojave. Të kenë trajnime inspektorët në fushën e të drejtave të punës të asistentëve personalë për PAK, me fokus në vlerësim të ndjeshëm gjinor, standarde të cilësisë, fuqizim të të drejtave dhe etikë.
- Të ndahem fonde për kryerjen e një vlerësimi të ndikimit gjinor sipas [Doracak për vlerësimin e ndikimit gjinor](#) të Agjencisë për Barazi Gjinore, për të mbështetur hartimin e ligjit gjithëpërfshirës dhe për të siguruar që dispozitat për asistencën personale të mos përforcojnë pabarazitë gjinore. Të konsultohen PAK të ndryshëm, OShC-të që i mbështesin dhe asistentët personalë për të mbështetur analizën.
- Të krijohen qendra ditore dhe qendra të pushimit (*respite care*) për të lehtësuar barrën e kujdesit 24-orësh të shumica e kujdestarëve, me kostot kapitale dhe operative të përfshira në planifikimin buxhetor shumëvjeçar.
- Të zhvillohen dhe të ndahen fonde të mjaftueshme për fushata ndërgjegjësimi publik dhe programe edukative për të promovuar vlerën e asistencës personale dhe të drejtave të PAK, për të reduktuar stigmatizimin dhe për ta njohur kujdesin si punë profesionale.

Për Ministrinë e Drejtësisë

- Të kryhet një rishikim i harmonizimit ligjor për të siguruar që legjislacioni kombëtar për personat me aftësi të kufizuara të jetë plotësisht në përputhje me parimet e KDPAK dhe kërkesat e legjislacionit të BE-së, veçanërisht lidhur me jetesën e pavarur dhe asistencën personale.
- Të kërkohet që çdo amendament apo ligj i ri (p.sh. Ligji gjithëpërfshirës) të përfshijë një plan të qartë financiar për zbatim, duke përfshirë vlerësimet e kostove, burimet e financimit dhe afatet kohore, për të siguruar zbatueshmëri, i zhvilluar në përputhje me praktikatat më të mira të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.
- Të sigurohen konsultime të rregullta me OJQ-të që mbështesin PAK dhe shoqatat e kujdestarëve për hartimin dhe monitorimin e legjislacionit për aftësinë e kufizuar, duke siguruar që politikatat të adresojnë nevojat reale, me fonde modeste për takime, punëtori dhe raportim me palë të interesuara.

- Të sigurohet që drafti i ligjit gjithëpërfshirës të bëhet publik për shqyrtim dhe konsultim nga OJQ-të, grupet avokuese për personat me aftësi të kufizuara dhe palët e tjera të interesuara, duke u mundësuar atyre të japin komente për të mbështetur hartimin e legjislacionit përfundimtar dhe për të siguruar që ai u përgjigjet nevojave të PAK.

Për Ministrinë për Punës, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare

- Të sigurohet që ligji i ardhshëm gjithëpërfshirës të njohë në mënyrë të qartë asistentët personalë si punonjës formalë, duke kërkuar kontrata të detyrueshme me shkrim, kontribute pensionale, sigurim shëndetësor, orar të rregulluar pune dhe mbrojtje për orët shtesë.
- Të sigurohet që ligji i ardhshëm gjithëpërfshirës të krijojë një kategori të veçantë ligjore për mbështetjen përmes asistencës personale dhe të përcaktojë që kompensimi për këtë shërbim të administrohet brenda një kornize formale të punësimit, përfshirë kontributet e sigurimeve sociale të financuara nga shteti për asistentët personalë, pa ulur përfitimet e PAK. Të paraqiten parashikime të detajuara fiskale për këto kontribute.
- Brenda ligjit të ardhshëm gjithëpërfshirës, të krijohet një sistem i unifikuar, i bazuar në të drejta, për kompensimin financiar të asistencës personale, i zbatueshëm për të gjithë PAK, i përcaktuar përmes modelit bio-psiko-social të vlerësimit në përputhje me parimet e KDPAK-së, dhe jo mbi bazë kategorish, duke eliminuar pabarazitë ndërmjet grupeve të ndryshme të aftësisë së kufizuar. Të përfshihet një plan i detajuar buxhetor që mbulon zbatimin në nivel kombëtar, trajnimin e stafit, mekanizmat e monitorimit dhe kompensimet për të gjithë PAK.
- Në Planin e ardhshëm të Veprimit të SKDPAK-së, të njihet në mënyrë të qartë asistencë personale si një shërbim i jetesës së pavarur i bazuar në të drejta, në përputhje me nenin 19 të KDPAK-së. Të përfshihet një objektiv strategjik i veçantë me tregues të matshëm për sigurimin e disponueshmërisë së asistencës personale në nivel kombëtar, kritere të pranueshmërisë të bazuara në nevoja (jo në kategori), formalizimin dhe profesionalizimin e asistentëve personalë, si dhe mekanizma të qëndrueshëm financimi nga shteti, të pavarur nga skemat e pensioneve. Të përfshihet një plan shumëvjeçar financimi në përputhje me ligjin e ardhshëm gjithëpërfshirës për të siguruar zbatim në nivel kombëtar pa mungesa buxhetore.
- Të kërkohet që Ligji i ri për Vlerësimin, Njohjen e Statusit, Përfitimet dhe Shërbimet për Personat me Aftësi të Kufizuara të përmbajë një kapitull të veçantë që rregullon asistencën personale si një shërbim të veçantë, të bazuar në të drejta, duke përfshirë standarde minimale, mekanizma monitorimi dhe detyrime për komunat, si dhe njohjen formale të asistentëve personalë, si familjarë ashtu edhe jofamiljarë, brenda një kornize të rregulluar. Të sigurohet që komunat dhe shteti të kenë buxhete të alokuara për zbatimin, monitorimin dhe zbatimin e detyrimeve ligjore.

Për Ministrinë e Shëndetësisë

- Të vendosen rregullore për sigurimin e qasjes në shërbime psikologjike falas ose të subvencionuara për asistentët personalë, duke njohur barrën psikologjike të punës së kujdesit të vazhdueshëm, me linja buxhetore për staf, trajnime dhe ofrimin e shërbimeve.
- Të sigurohet që profesionistët shëndetësorë të marrin trajnime të specializuara për të marrë pjesë në mënyrë efektive në komisionet ndërdisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar,

të kërkuara nga ligji gjithëpërfshirës, në përputhje me modelin bio-psiko-social. Të përfshihen kostot e trajnimit dhe pjesëmarrjes në buxhetin vjetor të ministrisë.

- Të sigurohet që zbatimi i ligjit gjithëpërfshirës të njohë plotësisht aftësitë e kufizuara fizike, psiko-sociale, intelektuale dhe shqisore brenda kritereve për përfshirje në asistencën personale, të përcaktuara përmes vlerësimeve ndërdisiplinore në përputhje me modelin bio-psiko-social.

Për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

- Të zhvillohen programe të akredituara të aftësimin profesional dhe edukimit të vazhdueshëm për asistentët personalë, duke krijuar rrugë të formalizuara certifikimi dhe mundësi për avancim në karrierë, me fonde të dedikuara për certifikim, zhvillim profesional dhe trajnime të vazhdueshme.
- Të krijohet një mekanizëm i dedikuar financimi për mbulimin e kostove të asistentëve personalë në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm, me qëllim mbrojtjen e të drejtës për arsim.

Bibliografia

- ASK, *Anketa e fuqisë punëtore*, 2024.
- ASK, *Niveli i pagave në Kosovë*, 2024.
- Banka Botërore, *Disability Inclusion Kosovo Country Profile* [Profili i përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në Kosovë], 2023.
- BE, *Charter of Fundamental Rights* [Karta e të drejtave themelore], 2010.
- BE, *European Disability Strategy 2010-2020* [Strategjia Evropiane për Personat me Aftësi të Kufizuara 2010-2020], 2010.
- BE, *Guidance on independent living and inclusion in the community of persons with disabilities in the context of EU funding* [Udhëzime për jetesën e pavarur dhe përfshirjen në komunitet të personave me aftësi të kufizuara në kontekstin e financimit të BE-së], 2024.
- <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2837>
- KE, *Kosovo 2024 Report* [Raporti për Kosovën 2024], 2024.
- KE, *Social Protection for People with Disabilities – Kosovo* [Mbrotjja sociale për personat me aftësi të kufizuara - Kosovë], 2022.
- KE, *Strategy for the Rights of Persons with Disabilities 2021-2030* [Strategjia për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara 2021-2030], 2021.
- Kosovo 2.0, *Rritja e pagës minimale dhe ndryshimi i tatimit: Si ta kuptojmë?*, 2024.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, 2008.
- Kuvendi i Kosovës, *Ligji Nr. 2003/23 për Pensionet e Invalideve*, 2003
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji Nr. 03/L-022 për Mbështetjen Materiale për Familjet e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme*, 2008
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji Nr. 03/L-212 për Punën*, 2010
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji Nr. 04/L-131 për Skemat e Pensioneve të Financuara nga Shteti*, 2014
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji Nr. 04/L-92 për Personat e Verbër*, 2012.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrotjen nga Diskriminimi*, 2015.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji Nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor*, 2015
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave me Paraplegji dhe Tetraplegji*, 2016.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrotjen e Fëmijës*, 2019.
- Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji Nr. 08/L-255 për Shërbimet Sociale dhe Familjare*, 2024.
- OBSH, *Towards a Common Language for Functioning, Disability and Health: ICF* [Drejt një gjuhë të përbashkët për funksionimin, aftësitë e kufizuara dhe shëndetin: ICF], 2002
- OKB, , *Introducing the UNCRPD* [Hyrje në KDPAK së OKB-së], 2022.
- OKB, *Convention on the Rights of Persons with Disabilities* [Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara], 2006.
- OKB, *CRC General Comment No.9 (2006): The rights of children with disabilities* [Komenti i përgjithshëm nr. 9 i KDF-së (2006): Të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara], 2007.
- OKB, *CRPD General Comment No.5 on living independently and being included in the community* [Komenti i përgjithshëm nr. 5 i KDPAK mbi jetesën e pavarur dhe përfshirjen në komunitet], 2017.
- Organizata e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, *Situational Analysis on the Rights of Persons with Disabilities* [Analiza e situatës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara], 2025.
- Republika e Kosovës, *Plani i Veprimt për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës (2021-2023)*, 2020.
- Republika e Kosovës, *Strategjia kombëtare për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (2013-2023)*, 2013.
- Republika e Kosovës, *Strategjia për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (2025-2030)*, 2025.
- RrGK, *Analiza gjinore e transportit tokësor në Kosovë*, 2025.
- RrGK, *Financimi i përgjegjshëm gjinor për shoqëruarit e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë*, 2022.
- RrGK, grup i fokusit me OShC që punojnë me PAK, prill 2022.

RrGK, [*Nën hije: Analizë gjinore e punës joformale në Kosovë*](#), 2024.
UN Women, [*Profili Gjinor i Kosovës*](#), 2024.
UNICEF, [*Analiza e situatës: Fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë*](#), 2017
UNICEF, [*Rishikimi i sistemeve të të dhënave administrative për fëmijët me aftësi të kufizuara-Çështjet e lidhura me mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë*](#), 2023.
UNICEF, [*The Legal Framework for Child Rights in Kosovo: A study of the compatibility of existing legislation with the Convention on the Rights of the Child*](#) [Korniza ligjore për të drejtat e fëmijëve në Kosovë: një studim mbi përputhshmërinë e legjislacionit ekzistues me Konventën për të Drejtat e Fëmijës], 2014.
UNMIK, [*Rregullorja nr. 2003/40*](#), 2003.

Shtojca 1.

Tabela më poshtë paraqet numrin e personave që jetojnë me të paktën një aftësi të kufizuar të vazhdueshme, të kategorizuar sipas grupmoshës dhe gjinisë. Ajo tregon se dëmtimet fizike bazë (31,567 raste) dhe “sëmundjet e tjera afatgjata” (28,611 raste) janë më të përhapurat, të pasuara nga shurdhëria ose dëmtimet e rënda të dëgjimit (9,935 raste), vështirësitë psikologjike ose emocionale (8,133 raste) dhe aftësitë e kufizuara në të nxënë ose intelektuale (5,607 raste). Së bashku, kategoritë që lidhen me dëmtimet fizike dhe sëmundjet përbëjnë mbi 64% të të gjitha gjendjeve të raportuara.

Një prirje e qartë në të dhëna është se, me rritjen e moshës së popullsisë, përhapja e vështirësive fizike dhe shqisore rritet ndjeshëm; për shembull, dëmtimet fizike bazë rriten nga 1,050 në grupmoshën 0–14 në 3,757 në grupmoshën 70–74. Për më tepër, ndërsa burrat raportojnë nivele më të larta të disa llojeve të aftësisë së kufizuar në grupmoshat më të reja - si 377 raste të vështirësive në të nxënë, 366 vështirësi psikologjike dhe 188 raste të shurdhërisë, krahasuar me 307, 250 dhe 167 për gratë përkatësisht në grupmoshën 0–14 - gratë përbëjnë një pjesë shumë më të madhe të popullsisë që jeton me vështirësi në kategoritë mbi 60 vjeç. Ky ndryshim reflektohet në një total prej 49,910 rastesh të raportuara për gratë, krahasuar me 43,378 për burrat.

Në përfundim, të dhënat e regjistrimit të popullsisë tregojnë se dëmtimet fizike dhe problemet kronike shëndetësore janë faktorët kryesorë që kontribuojnë në aftësinë e kufizuar në Kosovë, ndërsa sfidat shqisore dhe psikologjike gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm, me një përqendrim më të theksuar te gratë dhe popullsia e moshuar.

Popullsia me të paktën një vështirësi të vazhdueshme sipas gjinisë, moshës dhe llojit të aftësisë së kufizuar				
Mosh a	Vështirësi të vazhdueshme	Gjiths ej	Djem/Bur ra	Vajza/Gr a
0-14	Shurdhëri ose dëmtim i rëndë i dëgjimit	355	188	167
	Verbëri ose dëmtim i rëndë i shikimit	431	235	196
	Dëmtim bazë fizik	1050	569	481
	Vështirësi në të nxënë ose aftësi të kufizuara intelektuale	684	377	307
	Vështirësi psikologjike ose emocionale e vazhdueshme	616	366	250
	Të tjera, përfshirë sëmundje të vazhdueshme	865	479	386
	15-19	Shurdhëri ose dëmtim i rëndë i dëgjimit	123	72
Verbëri ose dëmtim i rëndë i shikimit		155	94	61
Dëmtim bazë fizik		513	311	202
Vështirësi në të nxënë ose aftësi të kufizuara intelektuale		348	200	148
Vështirësi psikologjike ose emocionale e vazhdueshme		351	217	134
Të tjera, përfshirë sëmundje të vazhdueshme		418	275	143
20-24		Shurdhëri ose dëmtim i rëndë i dëgjimit	200	117
	Verbëri ose dëmtim i rëndë i shikimit	127	73	54
	Dëmtim bazë fizik	562	318	244
	Vështirësi në të nxënë ose aftësi të kufizuara intelektuale	315	173	142
	Vështirësi psikologjike ose emocionale e vazhdueshme	385	219	166
	Të tjera, përfshirë sëmundje të vazhdueshme	398	222	176
	25-29	Shurdhëri ose dëmtim i rëndë i dëgjimit	191	114
Verbëri ose dëmtim i rëndë i shikimit		135	72	63
Dëmtim bazë fizik		608	377	231
Vështirësi në të nxënë ose aftësi të kufizuara intelektuale		318	179	139

	Vështirësi psikologjike ose emocionale e vazhdueshme	456	251	205
	Të tjera, përfshirë sëmundje të vazhdueshme	522	281	241
30-34	Shurdhëri ose dëmtim i rëndë i dëgjimit	212	147	65
	Verbëri ose dëmtim i rëndë i shikimit	146	84	62
	Dëmtim bazë fizik	926	588	338
	Vështirësi në të nxënë ose aftësi të kufizuara intelektuale	334	197	137
	Vështirësi psikologjike ose emocionale e vazhdueshme	536	300	236
	Të tjera, përfshirë sëmundje të vazhdueshme	708	377	331
35-39	Shurdhëri ose dëmtim i rëndë i dëgjimit	245	154	91
	Verbëri ose dëmtim i rëndë i shikimit	220	137	83
	Dëmtim bazë fizik	1312	794	518
	Vështirësi në të nxënë ose aftësi të kufizuara intelektuale	366	189	177
	Vështirësi psikologjike ose emocionale e vazhdueshme	738	412	326
	Të tjera, përfshirë sëmundje të vazhdueshme	1178	578	600
40-44	Shurdhëri ose dëmtim i rëndë i dëgjimit	321	187	134
	Verbëri ose dëmtim i rëndë i shikimit	299	163	136
	Dëmtim bazë fizik	1644	873	771
	Vështirësi në të nxënë ose aftësi të kufizuara intelektuale	351	188	163
	Vështirësi psikologjike ose emocionale e vazhdueshme	780	442	338
	Të tjera, përfshirë sëmundje të vazhdueshme	1497	654	843
45-49	Shurdhëri ose dëmtim i rëndë i dëgjimit	401	239	162
	Verbëri ose dëmtim i rëndë i shikimit	488	268	220
	Dëmtim bazë fizik	2181	1125	1056
	Vështirësi në të nxënë ose aftësi të kufizuara intelektuale	294	139	155
	Vështirësi psikologjike ose emocionale e vazhdueshme	725	384	341
	Të tjera, përfshirë sëmundje të vazhdueshme	2068	905	1163
50-54	Shurdhëri ose dëmtim i rëndë i dëgjimit	564	319	245
	Verbëri ose dëmtim i rëndë i shikimit	732	404	328
	Dëmtim bazë fizik	2587	1243	1344
	Vështirësi në të nxënë ose aftësi të kufizuara intelektuale	312	138	174
	Vështirësi psikologjike ose emocionale e vazhdueshme	693	364	329
	Të tjera, përfshirë sëmundje të vazhdueshme	2915	1167	1748
55-59	Shurdhëri ose dëmtim i rëndë i dëgjimit	687	381	306
	Verbëri ose dëmtim i rëndë i shikimit	946	468	478
	Dëmtim bazë fizik	3211	1459	1752
	Vështirësi në të nxënë ose aftësi të kufizuara intelektuale	284	109	175
	Vështirësi psikologjike ose emocionale e vazhdueshme	667	345	322
	Të tjera, përfshirë sëmundje të vazhdueshme	3430	1347	2083
60-64	Shurdhëri ose dëmtim i rëndë i dëgjimit	928	471	457
	Verbëri ose dëmtim i rëndë i shikimit	1073	481	592
	Dëmtim bazë fizik	3515	1485	2030
	Vështirësi në të nxënë ose aftësi të kufizuara intelektuale	340	150	190
	Vështirësi psikologjike ose emocionale e vazhdueshme	595	284	311
	Të tjera, përfshirë sëmundje të vazhdueshme	3817	1487	2330
65-69	Shurdhëri ose dëmtim i rëndë i dëgjimit	1197	626	571
	Verbëri ose dëmtim i rëndë i shikimit	1170	567	603
	Dëmtim bazë fizik	3745	1566	2179
	Vështirësi në të nxënë ose aftësi të kufizuara intelektuale	368	144	224
	Vështirësi psikologjike ose emocionale e vazhdueshme	464	199	265
	Të tjera, përfshirë sëmundje të vazhdueshme	3764	1454	2310
70-74	Shurdhëri ose dëmtim i rëndë i dëgjimit	1434	777	657
	Verbëri ose dëmtim i rëndë i shikimit	1189	573	616
	Dëmtim bazë fizik	3757	1584	2173
	Vështirësi në të nxënë ose aftësi të kufizuara intelektuale	451	189	262
	Vështirësi psikologjike ose emocionale e vazhdueshme	456	196	260

	Të tjera, përfshirë sëmundje të vazhdueshme	3172	1351	1821
75-79	Shurdhëri ose dëmtim i rëndë i dëgjimit	1365	679	686
	Verbëri ose dëmtim i rëndë i shikimit	1091	514	577
	Dëmtim bazë fizik	3054	1244	1810
	Vështirësi në të nxënë ose aftësi të kufizuara intelektuale	403	130	273
	Vështirësi psikologjike ose emocionale e vazhdueshme	313	118	195
	Të tjera, përfshirë sëmundje të vazhdueshme	2177	818	1359
80+	Shurdhëri ose dëmtim i rëndë i dëgjimit	1712	781	931
	Verbëri ose dëmtim i rëndë i shikimit	1233	514	719
	Dëmtim bazë fizik	2902	1041	1861
	Vështirësi në të nxënë ose aftësi të kufizuara intelektuale	439	139	300
	Vështirësi psikologjike ose emocionale e vazhdueshme	358	120	238
	Të tjera, përfshirë sëmundje të vazhdueshme	1682	649	1033
Gjithsej	Shurdhëri ose dëmtim i rëndë i dëgjimit	9935	5252	4683
	Verbëri ose dëmtim i rëndë i shikimit	9435	4647	4788
	Dëmtim bazë fizik	31567	14577	16990
	Vështirësi në të nxënë ose aftësi të kufizuara intelektuale	5607	2641	2966
	Vështirësi psikologjike ose emocionale e vazhdueshme	8133	4217	3916
	Të tjera, përfshirë sëmundje të vazhdueshme	28611	12044	16567

Tabela më poshtë paraqet gjetjet sipas regjistrimit të popullsisë për vitin 2024, duke i ndarë llojet e aftësisë së kufizuar sipas moshës kur ka filluar vështirësia dhe sipas shkallës së saj (“Pak vështirësi” dhe “Shumë vështirësi”). Të dhënat këtu tregojnë një total prej 316,930 rastesh të raportuara të vështirësive, prej të cilave 238,953 janë kategorizuar si “vështirësi e lehtë/moderuar” dhe 77,977 si “vështirësi e madhe”. Të dhënat tregojnë se shikimi dhe lëvizshmëria janë sfidat më të përhapura, me 117,150 raste gjithsej për shikimin dhe 75,301 raste për ecjen ose ngjitjen, të cilat së bashku përbëjnë mbi 60% të të gjitha kufizimeve funksionale të raportuara.

Gjetjet kryesore tregojnë një rritje të ndjeshme të përhapjes dhe ashpërsisë së vështirësive në grupmoshat më të vjetra, veçanërisht për personat e moshës 50–69 vjeç, ku problemet e rënda të lëvizshmërisë arrijnë në 11,918 raste. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e vështirësive është raportuar si e pranishme që nga lindja, me gjithsej 14,126 raste, përfshirë një përqendrim të lartë të sfidave të rënda në komunikim (1,643 raste) dhe vetëkujdes (1,283 raste). Në përfundim, ndërsa shikimi dhe lëvizshmëria janë llojet kryesore të vështirësive në popullsinë e moshuar, nivelet e larta të sfidave në komunikim dhe vetëkujdes të pranishme që nga lindja theksojnë nevojën kritike për ndërhyrje të hershme dhe shërbime mbështetëse.

Vështirësitë funksionale sipas moshës dhe shkallës së ashpërsisë														
	Në të pamurit (me syze)		Me dëgjim (me aparat)		Në ecje/ngjitje		Në të nxënë/kujtesë		Në kujdesin ndaj vetës		Në komunikim		Gjithsej	
	Pak	Shumë	Pak	Shumë	Pak	Shumë	Pak	Shumë	Pak	Shumë	Pak	Shumë	Pak	Shumë
Gjithsej	98264	18886	39423	11742	49991	25310	26525	8879	14435	7747	10315	5413	238953	77977
%	6.20	1.19	2.49	0.74	3.15	1.60	1.67	0.56	0.91	0.49	0.65	0.34	15.07	4.92
Në lindje	2006	1116	728	652	1105	1138	1145	1317	1092	1283	1512	1643	7,588	7149

Nën 5 vjeç	2119	627	298	238	475	407	469	442	481	420	685	590	4,527	2724
5 deri 14 vjeç	5260	961	310	162	362	281	242	204	233	175	302	182	6,709	1965
15 deri 29 vjeç	7698	1210	848	354	1238	809	718	394	492	320	394	248	11,388	3335
30 deri 49 vjeç	20541	3680	4722	1390	8357	4461	3773	1136	1611	843	931	474	39,908	11984
50 deri 69 vjeç	46850	7949	20241	5023	26049	11918	12207	2784	5292	2271	3035	1029	113,674	30974
70+ vjeç	12509	3173	11807	3836	11808	6101	7611	2488	5048	2374	3231	1176	52,014	19148
Nuk e di	1281	170	469	87	597	195	360	114	186	61	225	71	3,118	698